



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 783/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Adnan Konushevcu kryesues, Afjete Sada-Gllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelet e paraqitura nga Leonita Fejza, Xhevdet Ferizi, Nehar Kelmendi, Junuz Fejza, Ilmi Shabani, Hysni Sylja, Oltion Ahmeti, Mërgime Buzolli, Gazmend Asllani, Albulena Gashi, Adelina Muja-Brahimi, Xhevrije Bahtiri-Ademi, Tafil Peci, Naser Muja, Enis Osmani, Muhamet Pllana, Fidan Ademi, Fitore Mehmeti-Behrami, Erseka Barani, Bekim Muja, Armend Bega, Avni Tahiri, Nusret Qubrel, Hysen Peci, Hanife Osmani, Hamdi Hasani, Gëzim Stavileci, Igballe Islami, Isa Uka, Lavdim Zeneli, Majlinda Kurti, Mustafë Shala, Rustem Haxhiu, Xhafer Preteni, Shkëlqim Ibrahim, Sami Latifi, Salih Meha, Fadil Veseli, Florina Qitaku, Vesa Broja, Egzon Hamza, Ferit Jashari, Fahri Shabani, Blerta Kalluni-Hajra, Arbenita Hasani, Anita Sherifi, Edon Sheremeti, Edison Tërrnava, Endrit Haliti, Fisnik Krasniqi, Valbona Sadiku, Shahin Fetahu, Nazmije Sejdiu, Marigona Murtaç, Muhamet Sylejmani, Granit Tmava, të gjithë kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Jugut, nga radhët e Subjekteve Politike LVV, LDK, PDK, dhe AKR, të cilët përfaqësohen sipas autorizimeve nga avokatet Berat dhe Mirsad Peci nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, kundër vendimit me numër 2948-2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, lidhur me Rezultatit Përfundimtar për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit, të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Lëndët e regjistruara në PZAP, sipas apeleve të kandidatëve: Leonita Fejza A.nr.783/2021, Xhevdet Ferizi A.nr.784/2021, Nehar Kelmendi A.nr.785/2021, Junuz Fejza A.nr.786/2021, Ilmi Shabani A.nr.787/2021, Hysni Sylja A.nr.788/2021, Oltion Ahmeti A.nr.789/2021, Mërgime Buzolli A.nr.790/2021, Gazmend Asllani A.nr.791/2021, Albulena Gashi A.nr.792/2021, PDK-dega ne Mitrovicë e Jugut A.nr.793/2021, Adelina Muja-Brahimi A.nr.796/2021, Xhevrije Bahtiri-Ademi A.nr.797/2021, Tafil Peci A.nr.798/2021, Naser Muja A.nr.799/2021, Enis Osmani A.nr.800/2021, Muhamet Pllana A.nr.801/2021, Fidan

Ademi A.nr.802/2021, Fitore Mehmeti-Behrami A.nr.803/2021, Erseka Barani A.nr.804/2021, Bekim Muja A.nr.805/2021, Armend Bega A.nr.806/2021, Avni Tahiri A.nr.807/2021, Nusret Qubreli A.nr.808/2021, Hysen Peci A.nr.809/2021, Hanife Osmani A.nr.810/2021, Hamdi Hasani A.nr.811/2021, Gëzim Stavileci A.nr.812/2021, Igballe Islami A.nr.813/2021, Isa Uka A.nr.814/2021, Lavdim Zeneli Anr.815/2021, Majlinda Kurti A.nr.816/2021, Mustafë Shala A.nr.817/2021, Rrustem Haxhiu A.nr.818/2021, Xhafer Preteni A.nr.819/2021, Shkëlqim Ibrahimimi A.nr.820/2021, Sami Latifi A.nr.821/2021, Salih Meha A.nr.822/2021, Fadil Veseli A.nr.823/2021, Vesa Broja A.nr.824/2021, Florina Qitaku A.nr.825/2021, Egzon Hamza A.nr.826/2021, Ferit Jashari Anr.827/2021, Fahri Shabani A.nr.828/2021, Blerta Kalluni-Hajra A.nr.829/2021, Arbenita Hasani A.nr.830/2021, Anita Sherifi A.nr.831/2021, Edon Sheremeti A.nr.832/2021, Edison Tërrnava A.nr. 833/2021, Endrit Haliti A.nr.834/2021, Fisnik Krasniqi A.nr.835/2021, Valbona Sadiku A.nr.836/2021, Shahin Fetahu A.nr.837/2021, Nazmije Sejdiu A.nr.838/2021, Marigona Murtaj Anr.839/2021, Muhamet Sylejmani A.nr.840/2021 dhe Granit Tmava A.nr.841/2021, të pranuar më datë 04.11.2021, të paraqitura kundër vendimit 2948-2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultatit Përfundimtar për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvend Komunal, bashkohen në një lëndë dhe udhëhiqen sipas lëndës me numër A.nr. 783/2021.

II. Pranohen pjesërisht të bazuara apelet e lartcekura, ashtu qe: **Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumërojë të gjitha fletëvotimet e kandidatëve të lartpërmendur për anëtarë të Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Jugut për subjektet politike LVV, LDK, PDK, dhe AKR, në Vendvotimet:

1101B/01R, 1101B/02R, 1101B/03D, 1102B/01R, 1102B/03R, 1102B/04R, 1102B/05R, 1102B/06R, 1102B/07R, 1102B/08R, 1102B/09R, 1102B/10R, 1102B/11R, 1102B/12R, 1102B/13R, 1102B/14R, 1102B/15R, 1102B/16R, 1102B/17D, 1102X/01R, 1102X/02R, 1102X/03R, 1102X/04R, 1102X/06R, 1102X/07R, 1102X/08R, 1102X/09R, 1102X/10R, 1102X/11R, 1102X/12R, 1102X/13R, 1102X/14D, 1103B/02R, 1103B/03R, 1103B/04R, 1103B/05R, 1103B/06R, 1103B/07R, 1103B/08D, 1104B/01R, 1104B/02R, 1104B/03R, 1104B/04R, 1104B/05R, 1104B/06R, 1104B/07R, 1104B/08R, 1104B/09D, 1105B/01R, 1105B/02R, 1105B/03R, 1105B/05R, 1105B/06R, 1105B/07D, 1106B/01D, 1109B/01R, 1109B/02R, 1109B/03R, 1109B/04R, 1109B/05R, 1111B/01R, 1111B/02R, 1111B/03D, 1112B/01R, 1112B/02R, 1112B/03R, 1112B/04R, 1112B/05D, 1113B/01R, 1113B/02D, 1114B/01R, 1114B/02D, 1115B/01R, 1115B/02D, 1116B/01R, 1116B/02R, 1116B/03D,

1117B/01R, 1117B/02R, 1117B/03D, 1118B/01D, 1120B/01D, 1121B/01R, 1121B/02D, 1122B/01R, 1122B/02D, 1123B/01D, 1124B/01D, 1125B/01D, 1126B/01D, 1127B/01D, 1128B/01D, 1129B/01R, 1129B/02D, 1130B/01D, 1132B/01D BM111/001, BM211/001, CB111/001, CB111/002, CB111/003, CB111/004, CB111/005, CB211/001, CB211/002, CB211/003, CB211/004, CB211/005.

III. Refuzohet e pabazuar pjesa tjetër e apelit lidhur me rinumërimin e fletëvotimeve ne vendvotimet: 1102B/02R; 1102X/05R; 1103B/01R; 1105B/04R; 1109B/06D.

IV. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Vendvotimet si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, me datën 04.11.2021 ka pranuar apelet si në pikën -I-, të dispozitivit, me të cilat kërkohet rinumërim i plotë i të gjitha vendvotimeve në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Parashtruesit e apelit theksojnë se gjatë procedurave të numërimit dhe të regjistrimit të votave në Formularët e Rezultateve të Kandidatëve-FRK, kanë shumë mospërputhje të votave për bartësit e listës së kandidatëve nga subjekti politik me numrin e votave të kandidatëve të po të njëjtit subjekt politik. Të njëjtit kërkojnë që të bëhet rinumërimi i plotë i kutive të votimit për kandidatet për Kuvend Komunal të Mitrovicës, për arsye se janë vërejtur shumë parregullsi gjatë numërimit të votave në vendvotime dhe KKZ në Mitrovicë, njëra ndër to është se disa prej këtyre kandidateve nuk kanë fare vota ne FRK, madje as votën e vet, dhe po ashtu ne disa raste ka një shpërputhje të madhe të rezultateve FRK.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, i ka bashkuar apelet e lartcekura dhe të njëjtat i trajton si një apel, të evidentuar me Anr.783/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve për çka të gjitha i vendosi me një vendim për hire të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, pas shqyrtimit të pretendimeve të apeleve, materialit zgjedhor dhe provave që gjinden në shkresat e lëndëve, gjeti se:

-apeli është i pjesërisht i bazuar.

Paneli vlerësoi se pretendimet ankimore janë të bazuara pasi që, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, si dhe nga hetimi i bërë në materialet zgjedhore, ka konstatuar se ka

mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja, me provat e ofruara nga pala ankuese, siç rezulton edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vet pala ankuese, dhe mungesë të votave për kandidatet e këtyre subjekteve deri në atë masë sa që disa prej kandidateve nuk kanë asnjë votë që do të thotë as votën e vet, çka është absurde dhe e pa pranueshme dhe për më tepër, rezultatin e numërimit e bën me bazë të pa pranueshëm. Vet fakti se kandidatët për anëtarë të subjekteve politike LVV, LDK, PDK, AKR, të certifikuara për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021, e kontestojnë se bashku numërimin e fletëvotimeve në Komunën e Mitrovicës së Jugut, për kandidatët për anëtar të Kuvendit, tregon se rezultati përfundimtar i shpallur nga KQZ, vërtetë është i kontestueshëm, i cili rezultat në bazë të argumenteve e provave të cilat gjenden në shkresa të lëndës, edhe sipas vlerësimit të PZAP-së, është bazë e mjaftueshme për rinumërim ashtu siç është vendosur me këtë vendim. PZAP-i gjen se, përveç tjerave, me rinumërim, askujt nuk i cenohet rezultati real dhe i vërtetë, përkundrazi për secilin kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Jugut, del rezultat zgjedhor i sigurt dhe i pranueshëm nga të gjithë.

Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për Kuvend Komunal në Mitrovicën e Jugut, nga subjektet politike LVV, LDK, PDK, dhe AKR, për vendvotimet e cekura si në pjesën -II-, të dispozitivit dhe rezultati i dal nga ky rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale 2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve, të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilën dispozitë përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Ndërsa në pjesën e III të dispozitivit ka refuzuar apelin për arsye se këto vendvotime veç se janë rinumëruar nga KQZ-ja, dhe nga këto rinumërimet janë evituar shumë parregullsi dhe përmirësime në vota, andaj Paneli konstaton se nuk ka arsye që të njëjtat vendvotime të rinumërohen përsëri.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 783/2021 më datën 05.11.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.